



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2021:141502  
Datë: 17.05.2024  
Numri i dokumentit: 05699355

AA.nr.693/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët, Hajriz Hoti kryetar, Ramiz Kuqi dhe Delushe Halimi anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit, B.Sh nga Prishtina, të cilin me autorizim e pëfaqëson, Shemdi Bunjaku, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës, Ministria Financave, Punës dhe Transfereve Inspektorati i Punës, me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit, përkitazi me ankesën e paditësit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje administrative, A.nr.1463/2021, të datës;06.07.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë;13.05.2024, merr këtë,

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit, B.Sh nga Prishtina, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1463/2021, i datës;06.07.2023, vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative, me aktvendimin A.nr.1463/2021, të datës;06.07.2023, ka vendosur, “*KONSIDEROHET - se është tërhequr padia e paditësit, B.Sh, nën shenjën A.nr.1463/21 e datës 01.07.2021, për shkak të mos pagesës së taksës gjyqësore për padi.*”

Kundër aktvendimit të lartcekur i autorizuari i paditësit, Shemdi Bunjaku, avokat nga Prishtina, ka ushtruar ankesë duke mos përmendur asnjë nga bazat ankimore nga neni 181 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, me propozim që aktvendimi i atakuar të anulohet për shkak të mos pagesës së takes gjyqësore për padinë e paraqitur.

Gjykata e Apelit shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 par.1 të LKA-së, lidhur me nenin 194 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për konfliktet administrative (LKA), ka gjetur se ankesa është e pa bazuar.

Kolegji i Gjykatës së Apelit - Departamenti për Çështje Administrative, duke vlerësuar ankesën e parashtruar nga paditësi. Aktvendimin e kundërshtuar si dhe shkresat e tjera të lëndës, ka konstatuar se paditësi ka parashtruar padi në gjykatën e shkallës së parë me datë;01.07.2021,

kundër të paditurës, Ministria Financave, Punës dhe Transfereve Inspektorati i Punës, me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit. Gjykata e shkallës së parë me datën 28.12.2022, paditësit ia ka dërguar vërejtjen për pagimin e taksës gjyqësore për padi në shumë prej 50 €, në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimit, dhe e ka udhëzuar paditësin që në rast të mos pagesës së taksës brenda afatit të caktuar padia do të konsiderohet e tërhequr. Nga fletë dërgesa për dorëzim personal rezulton se vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore paditësi e ka pranuar me dt. 13.02.2023. Mirëpo edhe pas kësaj vërejtjeje, e as me pas, i njëjti nuk e ka paguar taksën gjyqësore.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me aktvendimin e atakuar e ka konsideruar të tërhequr padinë e paditësit në këtë çështje të Konfliktit Administrativ, duke u bazuar në dispozitën e nenit 253.5 të LPK-së të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, për shkak të mos pagesës së taksës gjyqësore, lidhur me nenin 7 të Udhëzimit Administrativ nr.2008/2, për unifikimin e taksave gjyqësorë i ndryshuar dhe i unifikuar me vendimin e KGJK-së, nr.20/2012 dhe nr.37/2012 të datës 23.03.2012, si dhe Mendimit Juridik të dhënë nga Gjykata Supreme e Kosovës, me nr.64/2016, të datës;18.02.2016.

Me dispozitën e nenit 253.5 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, është përcaktuar se në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të paracaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirimin nga detyrimin i pagimit të taksës gjyqësore do të konsiderohet se padia është tërhequr.

Ndërsa me dispozitën e nenit 7 paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ nr.2008/02, lirimi nga pagesa e taksave parashihet në rastet e përcaktuara me këtë udhëzim, lirohet nga pagesa e taksës personi i cili parashtron kërkesa që kanë të bëjnë me marrëdhëniet e punës, përveç kërkesave në të holla, si dhe personi me gjendje të vështirë ekonomike, nëse pagesa e taksës ndikon drejtpërdrejtë në rrezikimin e ekzistencës së tij, respektivisht të anëtarëve të familjes së tij apo të personave tjerë të cilët varen nga ai. E kjo nga ankesa e parashtruar nga paditësi, sikurse edhe padia nuk është dëshmuar me asnjë provë.

Duke u bazuar në këto dispozita ligjore të lartcekura Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, me të drejtë ka konsideruar se është tërhequr padia e paditësit në këtë çështje të konfliktit administrativ, për shkak të mos pagesës së taksës gjyqësore.

Ngase pretendimet ankimore, se vërejtjen me shkrim për pagesën e taksës gjyqësore se në kohën e pranimit të vërejtjes paditësi e ka bërë shitblerjen e veturës që e ka pasur në posedim, ku dhe i është harruar në veturë shkresa e gjykatës dhe këtu ka ikur afati i pagesës së taksës, kolegji i apelit nuk i aprovoi, sepse vlerëson se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara, ngase të njëjtin pretendim nuk e ka mbështetur në asnjë provë të vetëm. Prandaj kjo gjykatë në tërësi i ka pranuar si të drejta arsyet juridike me të cilën është udhëhequr Gjykata e shkallës së parë gjatë nxjerrjes së aktvendimit të kundërshtuar.

Nga sa u tha më lart dhe në përputhje me nenin 49 të LKA-së, lidhur me nenin 209 pika b) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - PRISHTINË  
AA.nr.693/2023, datë;13.05.2024

Kryetari i kolegjit,  
Hajriz Hoti